

-S.T.I.M.P ✓
-Z. Gj. civile
-11.05.2022

BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 2637/Prot
Date 11.5.2022
krimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE

Korçë, me 09.05.2022

SHPLLJE VENDIMI

Drejtuar : Bashkise Maliq

Per: Nikollaq Kreka me adrese Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil nr. 309 dt. 22.04.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditore*, pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin : " Larguar ... " dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.



KANCELARE
Lubiana KINOLLI

U afishua ne Bashkine Maliq
Nenpunesi _____

(emer, mbiemer, firme)

Mr. 58 Post
Dt. 11.05.2022

1. The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records of all transactions and activities. It emphasizes the need for transparency and accountability in financial reporting.

2. The second part of the document outlines the various methods and techniques used to collect and analyze data. It includes a detailed description of the experimental procedures and the statistical analysis performed.

3. The final part of the document provides a summary of the findings and conclusions drawn from the study. It highlights the key results and discusses their implications for future research and practice.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr.regj.them.21001-00401-41-2021(826)
Datë regjistrimi 09.03.2022

Nr.vendimi 41-2022-1230(309)
Datë vendimi 22.04.2022

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues të përbërë prej:

Gjyqtarit të vetëm **Seladin PYSQYLI**, asistuar nga sekretare Enxhi Berberi, në gjykatë, sot më datë 22.04.2022, përfundoi gjykimin e çështjes civile me palë dhe objekt:

PADITËSE: **Mirela Kreka (mbiemri paramartesor Skenderaj)**, e bija e Jemin dhe Xhevo, e datëlindjes 30.03.1978, lindur në Patos, Fier, dhe banuese në Maliq, aktualisht në qëndrim në Gjermani, prezent në seancë pajtimore dhe përfaqësuar nga avokat Rizvaldo Vrenози, antar i Dhomës Vendore të Avokatisë Tiranë, i zgjedhur me prokurë të posacme nr.regj.266561106, datë 13.07.2021, hartuar para Konsullit të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, në Berlin, Gjermani.

I PADITUR: **Nikollaq Kreka**, i biri i Aleko dhe Kristina, i datëlindjes 29.09.1974, lindur në Korçë, dhe baues në Maliq, aktualisht me qëndrim jashtë vendit, në Greqi, në mungesë.

OBJEKTI: Zgjidhjen e martesës ligjore, të lidhur midis palëve më datë 17.09.1999, pa u shprehur gjykata në lidhje me fajësinë, dhe padtësja të mbajë mbiemrin aktual, Kreka.

Baza ligjore: Neni 129, 132 e vijues i K.Familjes.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të palës paditëse dhe në mungesë të të paditurit, përfaqësuesi i paditëses kërkoi zgjidhjen e martesës dhe padtësja të mbajë mbiemrin aktual, Kreka.

Gjykata, pasi dëgjoi palën paditëse dhe analizoi provat e marra në gjykim,

VËREN SE:

Me padinë drejtuar gjykatës, paditësja ka kërkuar zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur më datë 17.09.1999, midis saj e të paditurit Nikollaq Kreka dhe zgjidhjen e pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës.

Gjykata, pasi u njoh me padinë dhe aktet bashkëlidhur, referuar nenit 36/1 të K.Pr.Civile, konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor civil dhe bazuar në nenet 41 e 42 të K.Pr.Civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e saj. Referuar nenit 51 të K.Pr.Civile, kjo gjykatë ka edhe kompetencën tokësore, pasi është gjykata e vendit ku bashkëshortët kanë patur banimin e tyre të përbashkët të fundit, në qytetin e Maliqit, territor që është në kompetencën tokësore të kësaj gjykate.

Bazuar në nenin 134 të K.Familjes, gjykata thirri palët në seancë për pajtim ku u paraqit vetëm paditësja. I padituri nuk u paraqit në seancë pajtimore megjithse kishte dijeni të rregullt dy herë radhazi konform nenit 135/2 të K.Familjes, dhe nuk bëri prezent ndonjë shkak të

arsyeshëm. Me të paditurin u kontaktua edhe nëpërmjet telefonit, i cili deklaroi se nuk dëshiron të marrë pjesë në gjykim, pasi nuk mund të lerë punën, dhe është dakort që martesë të zgjidhet. Gjykata, pasi dëgjoi pretendimet e paditëses krijoi bindjen se pajtimi nuk mund të arrihet dhe bazuar në nenin 135/2 të K.Familjes e 158/c të K.Pr.Civile kaloi çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore. I padituri nuk u paraqiti as në seancë gjyqësore, megjithëse kishte dijeni të rregullt dhe nuk bëri prezent ndonjë shkak të arsyeshëm.

Paditësja paraqiti me cilësinë e provave, aktet e gjendjes civile, që janë: Çertifikata e martesës, çertifikata familjare dhe çertifikatat personale të palëve, nga të cilat rezulton se palët kanë lidhur martesën ligjore më datë 17.09.1999 dhe paditësja ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, nga Skenderaj në Kreka.

Nga deklaratimet e palës paditëse dhe provat e marra në gjykim, rezultoi se jemi para rrethanave të faktit si më poshtë:

-Paditësja Mirela Kreka me të paditurin Nikollaq Kreka janë bashkëshortë. Ata janë njohur në Greqi në vitin 1999 dhe në datën 17.09.1999 kanë lidhur martesën ligjore. Me lidhjen e martesës, paditësja ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, nga Skenderi në Kreka. Nga martesë kanë dy fëmijë madhorë, djali Janul Kreka i datëlindjes 02.05.2000 dhe vajza Aleksandra Kreka e datëlindjes 19.01.2003, të cilët kanë lindur në Selanik, Greqi.

-Pas lidhjes së martesës, palët kanë jetuar në Greqi ku kanë punuar dhe me të ardhurat e siguruara kanë përballuar normalisht jetesën. Gjatë viteve të para kanë patur mirëkuptim dhe i kanë dhënë mbështetjen morale e materiale njëri tjetrit. Pas disa vitesh kanë filluar grindje e mosmarrëveshje, që sipas paditëses vinin për shkakun e të paditurit, i cili ushtronte dhunë fizike dhe nuk tregonte interes për familjen e fëmijët. Sipas paditëses, ajo ka bërë përpjekje për të mbajtur familjen por ka qënë e pamundur dhe në vitin 2015 ka vendosur ti japë fund marrëdhënieve bashkëshortore. Deri në vitin 2018 kanë jetuar në të njëjtën banesë për shkak të fëmijëve por pa mbajtur marrëdhënie si bashkëshortë. Në vitin 2018, paditësja është larguar në Gjermani ku pas 3 muajve ka marrë djalin, ndërsa vajzën e ka marrë pas rreth një viti për Aktualisht djali vazhdon universitetin në Greqi kurse vajza është në Gjermani me paditësen.

-Pas veçimit, palët nuk kanë bërë asnjë përpjekje për pajtim dhe nuk kanë patur biseda as nëpërmjet telefonit. Paditësja ka lidhur martesë fakti me një shtetas gjerman, nga e cila i kanë lindur dy fëmijë, kurse i padituri ka jetuar vetë në Greqi dhe paditësja është vënë në dijeni që edhe ai ka krijuar një lidhje të re. Nisur nga fakti që marrëdhëniet bashkëshortore janë ndërprerë prej më shumë se 6 vite, paditësja i është drejtuar me padi gjykatës duke kërkuar zgjidhjen e martesës. Edhe pas ngritjes së padisë nuk janë bërë përpjekje për pajtim dhe paditësja insistoi në zgjidhjen e martesës sa më shpejt, pasi kjo po e pengon të lidhë martesën e re dhe të bëjë regjistrimin e fëmijëve që ka nga bashkëjetesa në Gjermani.

Në lidhje me sa më sipër, paditësja deklaroi se martesë ka marrë fund, si për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve bashkëshortore prej viti 2015, ashtu dhe për faktin që aktualisht ka dy fëmijë nga martesë e dytë faktike në Gjermani. Po kështu, ajo deklaroi se, nga djali është vënë në dijeni, që edhe i paditurit ka krijuar lidhje të re. Gjatë kësaj kohe është kujdesur vetë për fëmijët, si dhe është ndihmuar financiarisht nga bashkëjetuesi.

Bazuar në faktin si më sipër, gjykata çmon se martesë e ka humbur qëllimin e saj, duke mbetur thjesht formale, prandaj padia duhet të pranohet duke u vendosur zgjidhja e martesës. Kjo, edhe për faktin që paditësja ka lidhur martesë tjetër fakti nga e cila ka dy fëmijë. Paditësja legjitimohet të kërkojë zgjidhjen e martesës, pasi me të paditurin janë bashkëshortë dhe padia gjen mbrojtje ligjore në nenet 129 e 132 të K.Familjes, pasi ajo i është referuar si faktit që marrëdhëniet bashkëshortore janë ndërprerë prej më shumë se 3 vite ashtu

dhe mosmarrëveshjeve që kanë patur për shkak të sjelljes jo korrekte të të paditurit. Neni 129 i K.Familjes, i titulluar: "Zgjidhja e martesës për ndërprerje të jetesës së përbashkët" parashikon se: "Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh. Nëse është rasti, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës, sipas paragrafit të parë të këtij neni, duhet të përcaktojë në kërkesëpadinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër". Rezultoi se, jetesa e përbashkët është ndërprerë rreth 7 vjet më parë dhe palët kanë jetuar të ndara faktikisht. Gjatë këtyre viteve, nuk kanë bërë asnjë përpjekje për pajtim dhe kanë ndërprerë çdo lloj marrëdhënie bashkëshortore. Po kështu, nuk rezultoi që të jemi para rasteve të parashikuara nga neni 130 i K.Familjes, kur nga zgjidhja e martesës për shkak të ndërprerjes së jetës së përbashkët i padituri mund të ketë pasoja të rënda morale apo materiale. Ai u njoftua rregullisht dhe në rast se do të kishte pretendime në lidhje me shkakun e ngritjes së padisë, bazuar në nenin 131/2 të K.Familjes, mund ta kundërshtonte duke ngritur kundërpadi, të drejtë që nuk e ushtroi.

Padia gjen mbrojtje ligjore edhe në nenin 132 të K.Familjes, i cili parashikon: "Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimit, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesë, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesë ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët". Midis bashkëshorteve ka patur mungesë mirëkuptimi, grindje e mosmarrëveshje, të cilat kanë ardhur duke u shtuar dhe kanë çuar në veçimin e tyre, ku sipas paditëses, shkaku thelbësor ka qënë dhuna dhe mungesa e interesimit për familjen nga i padituri. Nga sa më sipër, janë shkelur detyrimet që rrjedhin nga martesë, pasi: Me lidhjen e martesës, të dy bashkëshortëve u lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës (neni 50 i K.Familjes); Të dy bashkëshortët kanë detyrimin për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët, duke pasur parasysh aftësitë, prirjet natyrore dhe dëshirat e fëmijëve (neni 53 i K.Familjes); Të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre (neni 54 i K.Familjes); Kanë detyrimin e jetesës së përbashkët (neni 55 i K.Familjes); Rezultoi se këto detyrime nuk janë respektuar, pasi midis palëve ka munguar bashkëpunimi e mirëkuptimi dhe palët kanë gjetur si zgjidhje ndërprerjen e marrëdhënieve bashkëshortore dhe të jetesës së përbashkët.

Në kushtet kur konkludohet për zgjidhjen e martesës, gjykata ka detyrimin ligjor të shprehë për zgjidhjen e pasojave që vijnë për bashkëshortët dhe fëmijët.

1-Në lidhje me pasojat për bashkëshortët, paditësja nuk ngriti pretendime për kontribut apo për të drejtën e përdorimit të banesës prandaj gjykata çmon se nuk ka vend për tu shprehur në lidhje me këto të drejta e detyrime të parashikuara në nenet 147-153 të K.Familjes.

E vetmja kërkesë në lidhje me pasojat për bashkëshortët, ishte që paditësja të mbajë mbiemrin aktual, pasi gjithë dokumentacionin në Greqi dhe Gjermani e ka me mbiemrin Krela dhe në rast se do të marrë mbiemrin paramartesor, kjo do të jetë me kosto të madhe financiare dhe do të zvaritë procedurën për lidhjen e martesës në Gjermani. Gjikata çmon se, ky kërkesë është i drejtë dhe duhet të pranohet, pasi gjen mbrojtje ligjore në nenin 146 të K.Familjes, i cili përcakton: "Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës.

Gjikata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës". Gjikata çmon se mbajta

e mbiemrit aktual është në interesin e paditëses, pasi u provua se prej vitit 1997 ka jetuar në Greqi, ku të gjithë dokumentacionin dhe lejen e qëndrimit i ka me mbiemrin Kreka. Po kështu, edhe në Gjermani, ku jeton prej vitit 2018, të gjithë dokumentacionin e ka me mbiemrin Kreka. Në këto rrethana, mospranimi i kërkesës do të ishte me pasoja negative, si përsa i takon shpenzimeve për paisjen me dokumentacion të ri me mbiemrin e ndryshuar ashtu dhe kohëzgjatjes për hartimin e dokumentacionit, në një kohë që ajo ka lindur dhe dy fëmijë nga bashkëjetesa.

2-Përsa i takon zgjidhjes së pasojave në lidhje me fëmijët, rezultoi se palët kanë dy fëmijë të lindur nga martesja, djali Janul Kreka i datëlindjes 02.05.2000 dhe vajza Aleksandra Kreka e datëlindjes 19.01.2003. Gjykata çmon se për fëmijët nuk ka vend për tu shprehur në lidhje me të drejten e ushtrimit të përgjegjësise prindërore, pasi neni 216 i K.Familjes përcakton: "Fëmija ndodhet nën përgjegjësinë prindërore deri në arritjen e moshës madhore". Fëmijët kanë arritur moshën madhore që para ngritjes së padisë dhe nisur nga ky fakt, ata vendosin vetë me cilin prind dëshirojnë të qëndrojnë apo të jetojnë më vete. Në lidhje me detyrimin për kontribut ushqimor, neni 197/3 i K.Familjes përcakton: "Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç" kurse neni 198 parashikon: "Detyrimi për ushqim lind vetëm për personi që kërkon këtë detyrim është i paafte për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar". N.q.s. fëmijët vazhdojnë shkollën dhe nuk kanë të ardhura për të përballuar jetesën, në kushtet kur kanë arritur moshën madhore dhe kanë zotësinë e plotë për të vepruar, mund t'i drejtohen vetë gjykatës me padi dhe të kërkojnë detyrimin e prindërve të japin kontribut për ta.

Përsa i takon shpenzimeve gjyqësore, ato përbëhen nga tarifa mbi aktet në vlerën 3,000 lek dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, të cilat duhet të lihen siç janë kryer, pasi pala paditëse nuk kërkoi të disponohet ndryshe por të lihen në ngarkim të saj.

Bazuar në nenin 143 të K.Familjes, pasi vendimi të marrë formë të prerë, sekretaria gjyqësore ti dërgojë një kopje Z.Gj.Civile Maliq për të bërë ndryshimet përkatëse në regjistër.

M.q.s. vendimi nuk përmban detyrime nuk përbën titull ekzekutiv dhe për rrjedhim nuk jemi para rasteve të parashikuara nga nenet 510 e 511 të K.Pr.Civile për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 129, 132 e vijues të K.Familjes,

VENDOSI:

- 1-Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur më datë 17.09.1999 midis paditëses Mirela Jemin Kreka dhe të paditurit Nikollaq Aleko Kreka.
 - 2-Pas zgjidhjes së martesës, paditësja Mirela do të mbajë mbiemrin aktual, Kreka.
 - 3-Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë kryer.
 - 4-Urdhërohet sekretaria e gjykatës që, pasi vendimi të marrë formë të prerë, ti dërgojë një kopje të tij Z.Gj.Civile Maliq për të bërë ndryshimet përkatëse në regjistër.
 - 5-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall në Korçë, sot më datë 22.04.2022.

SEKRETARE
Enxhi BERBERI

GJYQATAR
Seladin PYSQYLI

